



**FONDACIONI “ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE
DHE PAJTIMI I MOSMARRËVESHJEVE”**
Rruga “Him Kolli”, Pall. P.F.Trade, Nr. 5, Tiranë
Tel: +355 68 20 23 882
E-mail: mediationalb@abcmail.al
Web: www.mediationalb.org

Terma Reference për Ekspertë

Datë: 6 Mars 2018

| | |
|--------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|
| Titulli i Projektit: | “Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom” |
| Koha e zbatimit të projektit: | 01 Shkurt 2018 – 31 Korrik 2020 |
| Koha e angazhimit: | Maj 2018 – Dhjetor 2018 |
| Donatori | Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri |

Informacion për Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” (FZKPM)

FZKPM është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse e jopolitike, e hapur për bashkëpunim me organizata e fondacione të tjera për të kontribuar në demokratizimin e shoqërisë shqiptare. Fushat kryesore të aktivitetit të FZKPM-së janë trajtim dhe menaxhim konfliktësh dhe mosmarrëveshjeve të fushës civile, familjare dhe penale, veçanërisht të fokusuar në drejtësinë restauruese për të miturit; ekspertizë në përmirësimet e bazës ligjore për ndërmjetësimin; trajnime në fushën e kualifikimit të avancuar të ndërmjetësve në nivel kombëtar dhe rajonal bazuar në standardet e Institutit Ndërkombëtar të Ndërmjetësimit (IMI); publikime dhe ndërgjegjësim në fushën e negocimit, ndërmjetësimit, lehtësimit; edukim për zgjidhje konfliktësh në grupmoshat shkollore përmes dialogut restaurues dhe transformimit të konfliktëve.

Përshkrim i Projektit

Projekti “Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom” financohet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe zbatohet nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike- ANTTARC, në partneritet me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve - AFCR dhe Unionin për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri- Amaro - Drom.

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane përmes advokimit për qeverisje të mirë dhe llogaridhënies nga institucionet publike përgjegjëse.

Qëllimi i angazhimit

Si pjesë e komponentit të rritjes së kapaciteteve dhe aftësive të stafit të organizatave të shoqërisë Civile Rome dhe Egjiptiane që janë aktive në zbatimin e të drejtave të këtyre komuniteteve, në fushën e lehtësimit/negocimit dhe ndërmjetësimit,

FZKPM fton persona të interesuar të aplikojnë për t'u përfshirë si ekspertë në aktivitetet e mëposhtme:

- Përgatitje modulesh në fushën e mentorimit/këshillimit/zgjidhjes së problemeve në komunitet.
- Trajnim në fushën e mentorimit/këshillimit dhe zgjidhjes së problemeve në komunitet për drejtuesit e Komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Modulet e trajnimit do të përfshijnë tema si më poshtë:

- Koncepti dhe praktika e mentorimit.
- Rastet ku mund të përdoret mentorimi.
- Diversiteti kulturor dhe përdorimi i qasjes psikologjike në procesin e mentorimit.
- Si të ndihmojmë dhe mbështesim romët, veçanërisht fëmijët, të miturit dhe gratë
- Raste studimore / praktika të mira në aplikimin e metodës së mentorimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit

- Të përgatisë modulet për të prezantuar në aktivitetet e sipërpërmendura;
- Të koordinojë me FZKPM-në për përgatitjen e programit trajnues;
- Të dorëzojë modulën e përgatitur në afatin e përcaktuar;
- Të prezantojë modulën përkatës në aktivitet;

Përgjegjësitë e FZKPM-së

- Të koordinojë me grupin e ekspertëve për përgatitjen e programit të aktivitetit;
- Të verë në dispozicion të ekspertëve materiale të nevojshme;
- Të ofrojë informacionin e nevojshëm për ekspertët.

Personi i kontaktit: Rasim Gjoka, Koordinator Projekti, FZKPM

Kualifikimet dhe eksperiencat e kërkuar

- Të ketë ekspertizë në fushën e ndërmjetësimit, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, këshillimit, jo më pak se 5 vjet.

Dorëzimi i aplikimeve:

Aplikantët e interesuar të dërgojnë dokumentet e mëposhtme ose në adresën e e-mail-it:

mediationalb@abcmail.al :

- Një letër të shkurtër shprehje interesi
- CV

Ose me postë në adresën:

Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”

Rruga “Him Kollit”, Pall.P.F.Trade, Nr. 5, Tiranë

Afati i dorëzimit: 25.03. 2018.

Përzgjedhja e individëve do të bazohet në:

- Përmbushjen e kritereve të përcaktuara më lart.